32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjesisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjesisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjesisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimit përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dënshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Paguesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Paga pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

#### **Neni 40**                    **Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41**                    **Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43**                    **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**KUSHTET E VEÇANTA**  
**616-24-11076-5-2-1/C1654**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK   |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |   |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
|   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe.</b>  |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është EUR apo 10 % për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj.   |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | <p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</li> <li>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</li> <li>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</li> <li>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> <li>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> </ul> </li> </ul> |
| Programi                                  | 12.1      | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.   |
|   | 12.2      | Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.  |

|  |           |   |
|--|-----------|---|
| Fillimi i punëve                                   | 17.1      | Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të planit të menaxhimit.  |
|  | 17.2      | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 12 muaj.   |
| Regjistri i punës                                  | 20.1      | Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.  |
| Inspektimi dhe testimi                             | 22.1      | Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës   |
| <b>Parimet e përgjithshme të pagesave</b>          | <b>24</b> | Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga <b>50000 € për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës.</b>  |
| Parapagimi   | 26.1      | Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>   |
| Mbajtja e Parasë                                   | 27.1      | Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% i vlerës se kontratës.</b><br><br>Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe <b>do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.</b><br><br>Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.<br><br><b>Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve.</b> |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1      | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.  |
| Përgjegjësia mbi Defektet                          | 34.5      | Periudha garantuese e defekteve është 1 vit.  |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës                 | 39.1      | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara   |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2      | <b>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë</b>   |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1      | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.  |

| NR. | PERSHKRIMI I POZICIONIT   | NJESIA         | SASIA | ÇMIMI    | TOTALI   |
|-----|---|----------------|-------|----------|----------|
| 1   | Përgatitja e vendpunishtës, punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtes dhe të ketë depon-kontinjencën për materialet e ndryshme parciaisht sipas zhvillimit të punimeve në terren. Rrethimi i punishtës të bëhet me panela lëvizës rrethues h=2.0m dhe me shpalzimin e nevojshëm. Pas përfundimit të punimeve të njëjtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i të gjithë zonës punuese.  | m <sup>2</sup> | 1     | 100.00 € | 100.00 € |
| 2   | Pozicionimi gjeodezik dhe shenjëzimi i gërmimeve dhe mbushjeve, rrugët, trotuarit, siarizat, hapësirat specifike etj. Në këtë pozicion nënkupohet kryerja e këtyre matjeve gjatë gjithë penudhës që kërkohet në shërbim i tillë në procesin e lëvizshëm të punimeve.  | m <sup>2</sup> | 1     | 1.50 €   | 1.50 €   |
| 3   | Demolimi i fushës sportive eksistuese. Pozicioni përfshinë demolinin e shtresës së pllakës beton arme (asfalt beton) eksistuese si dhe gërmimin e shtresës së dheut deri në nivelin e caktuar me projekt. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponi në përputhje me normativat ndërtimore.   | m <sup>2</sup> | 1     | 15.00 €  | 15.00 €  |
| 4   | Demolimi i konstruksionit të betonëve të murëve dhe çelëve nga betoni armëja me dimensione të ndryshme, shkallëve të ndryshme nga betoni armëja dhe transporti dhe largimi i tyre deri në deponi.   | m <sup>2</sup> | 1     | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 5   | Demolimi i rrethojave eksistuese nga konstruksioni metalik të fushave dhe demolimi i rrjetave të vjetra. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponi në përputhje me normativat ndërtimore. Llogaria në metër gjatësi, lartësia e rrethojës deri 5 metra.  | m <sup>2</sup> | 1     | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 6   | Demolimi i shkallëve anësore për të krijuar hapësirë më të gjërë për qasje. Demolimi është komplet i betonit të shkallëve dhe murti afër për zgjerim. Llogaria për m <sup>2</sup> të demoluar, në llogari hyjnë edhe transporti i materialit në deponin e caktuar nga organet kompetente.   | m <sup>2</sup> | 1     | 12.00 €  | 12.00 €  |
| 7   | Demolimi i rampave, pjesa mbrenda mureve për të krijuar rampat sipas projektit, në këtë demolin hyjnë edhe muret anësore që është e nevojshme që të përshihet murti me rampën e re si dhe të krijohet mundësi vazhdimi në pjesë të caktuara. Llogaria për m <sup>2</sup> të demoluar. Në llogari janë të parapara të përfshihen edhe kubëzat e rampave e edhe betonit. Në llogari të jenë edhe transporti i materialit të demoluar në deponin e caktuar nga organet kompetente. | m <sup>2</sup> | 1     | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 8   | Demolimi i kubëzave në tratuare dhe sheshet ku ka lëvizje. Llogaria për m <sup>2</sup> të demoluar. Kubëzat e demoluara të deponohen në një depo të caktuar nga organet kompetente komunale.  | m <sup>2</sup> | 1     | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 9   | Demolimi i anësoreve të kubëzave të të gjitha llojeve për të krijuar nivelin e kërkuar me projekt të kubëzave. Në llogari hyjnë komplet demolimi edhe me betonin i cili është përdorur për shlarat të kubëzave. Anësoret e demoluara të deponohen në deponin e caktuar nga organet kompetente. Llogaria për m gjatësi të demoluar.  | m <sup>2</sup> | 1     | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 10  | Punimi i mbushjes së sipërfaqeve për realizimin dhe zgjerimin e niveleve të gjelbrimit si në pjerrësi ashtu edhe në sipërfaqet e rrafshëta, me sasi nga gërmimi (me dheun cilësor) dhe me huazim. Në llogari të hyjnë edhe ngjeshja e terentit në trashësi sipas gjendjes në terren.  | m <sup>2</sup> | 1     | 18.00 €  | 18.00 €  |
| 11  | Punimet e kallupimit, furnizimi dhe sjellja e betonit C 25/30, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e pllakës beton arme me trashësi 15 cm.  | m <sup>2</sup> | 1     | 45.00 €  | 45.00 €  |
| 12  | Furnizimi me material dhe sanimi i fushës eksistuese nga betoni C-25/30, duke përfunduar si baze për vendosjen e shtresës finale të fushës (tereni duhet të rrafshohet mire dhe të jetë stabil), mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve (trashësia mesatare e betonit të armuar për sanimin dhe rrafshimin e pllakës është 10 cm).   | m <sup>2</sup> | 1     | 35.00 €  | 35.00 €  |

|    |  |                |   |          |          |
|----|--|----------------|---|----------|----------|
| 13 | Punimi i mureve tërthore ndaj kaskadave kryesore, në pjesën e derivelimeve në pjesët anësore të shkallëve nga konstruksioni i betonarmesë C-30/37 me dimensione sipas Projektit. Në çmim të llogaritë komplet betoni për mur dhe themelet. Llogaria për sasinë e egzektuar në vend.  | m <sup>2</sup> | 1 | 180.00 € | 180.00 € |
| 14 | Furnizimi dhe betonimi i trotuarve për rreth terreneve sportive sipas kërkesave me beton me trashësi 15 cm si dhe vendosja e armaturës rreth Q 335 15/15 cm  | m <sup>2</sup> | 1 | 60.00 €  | 60.00 €  |
| 15 | Furnizimi dhe punimi i mureve betonarme në pjesët e ngjitura të rampave për invalid (mbyllja anësore). Betoni të jetë C30/37 i armuar me rrejtë Ø8/15x15 cm në dy zona. Llogaria për m <sup>2</sup> të punuar bashkë me themelet.  | m <sup>3</sup> | 1 | 210.00 € | 210.00 € |
| 16 | Betonimi dhe armimi i shkallëve të ndryshme me C-30/37 dhe hekur Ø12/15 cm në pozicionet e paraqitura në projekt në dimensione përkatëse.  | m <sup>3</sup> | 1 | 215.00 € | 215.00 € |
| 17 | Betonimi i mureve të betonit me lartësi të ulët h <sub>mes</sub> =100 cm dhe me armim të lehtë rrejtë armature Ø10/15, dhe C-30/37. Dimensionet sipas Projektit. Për krijimin e nivelit të kërkuar të rampave.   | m <sup>3</sup> | 1 | 230.00 € | 230.00 € |
| 18 | Furnizimi me material dhe sanimi i fushës ekzistuese me bituagregat Bit 22. Në POS të perfshihen gjerëzja e asfaltit ekzistues, dhe asfaltimi i shtresës së re, transportimi dhe deponimi i asfaltit të gjerëzjer në deponi legale min. në largësi 5km. Sanimi i gropave ekzistuese. Lyezja me emulsion e shtresës së gjerëzjer. Trashësia mesatare 15 cm  | m <sup>2</sup> | 1 | 55.00 €  | 55.00 €  |
| 19 | Furnizimi, transporti, perpunimi i Bituagregalit Bit 22 me trashësi me trashësi T=7cm në gjendje të ngjeshur   | m <sup>2</sup> | 1 | 38.00 €  | 38.00 €  |
| 20 | Furnizimi, transporti, perpunimi i asfaltbetonit AB11 d=4cm në gjendje të ngjeshur.  | m <sup>2</sup> | 1 | 25.00 €  | 25.00 €  |
| 21 | Furnizimi me material dhe punimi i shtyllave të metalit forme □ 100x60x4 mm me gjatësi 200 cm. Shtyllat vendosen në çdo 2m aksiale njëra nga tjetra. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen, fillimisht me ngjyrë minimum (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa).   | cope           | 1 | 66.00 €  | 66.00 €  |
| 22 | Furnizimi me material dhe punimi i shtyllave të metalit forme □ 80x80x4 mm me gjatësi 200 cm. Shtyllat vendosen në çdo 2m aksiale njëra nga tjetra. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen, fillimisht me ngjyrë minimum (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa).  | cope           | 1 | 35.00 €  | 35.00 €  |
| 23 | Furnizimi me material dhe punimi i shtyllave të metalit forme □ 60x60x4 mm me gjatësi 200 cm. Shtyllat vendosen në çdo 2m aksiale njëra nga tjetra. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen, fillimisht me ngjyrë minimum (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa).  | cope           | 1 | 25.00 €  | 25.00 €  |
| 24 | Furnizimi me material dhe punimi i bazamentit të shtyllave nga betoni i armua C25 me dim (40x50x60) cm. Në çmim duhet llogaritur edhe armaturën Ø8 dhe Ø10 për armim të themelit dhe shtresa e zhavorit me trashësi t=20 cm e ngjeshur.  | cope           | 1 | 45.00 €  | 45.00 €  |
| 25 | Furnizimi, punimi dhe montimi elementeve të gardhit rrethues metalik me h = 1.50 m konstruksioni nga profilet e çelikut – vertikalet me profile 20x20x2 mm të vendosur në çdo 14 cm. Lidhja e vertikaleve me shtyllat kryesore bëhet me dy horizontale 60x40x3 mm si në detalin e dhënë. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen, fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa). Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detajit dhe nën mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës. | m <sup>2</sup> | 1 | 155.00 € | 155.00 € |
| 26 | Furnizimi, punimi dhe montimi elementeve të gardhit rrethues metalik me h = 2.0 m konstruksioni nga profilet e çelikut – vertikalet me profile 40x20x2 mm të vendosur në çdo 14 cm. Lidhja e vertikaleve me shtyllat kryesore bëhet me dy horizontale 80x40x3 mm si në detalin e dhënë. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen, fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa). Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detajit dhe nën mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.  | m <sup>2</sup> | 1 | 175.00 € | 175.00 € |

|    |   |      |   |          |          |
|----|---|------|---|----------|----------|
| 27 | Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimenzion 5.50x1.50 m të pajisura komplet me lidhëse, baglama, dorëz dhe çelës. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorooues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.  | cope | 1 | 630.00 € | 630.00 € |
| 28 | Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimenzion 6.50x2.0 m të pajisura komplet me lidhëse, baglama, dorëz dhe çelës. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorooues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.   | cope | 1 | 750.00 € | 750.00 € |
| 29 | Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimenzion 1.0x2.0 m të pajisura komplet me lidhëse, baglama, dorëz dhe çelës. Në çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorooues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.  | cope | 1 | 200.00 € | 200.00 € |
| 30 | Furnizimi dhe punimi i rrethojës së rampave për invalid me profile Ø 63 mm përkatëse sipas skicave në projekt t=90 cm Shiko skicën. Llogaria për metër gjatësi të punuar.   | m'   | 1 | 65.00 €  | 65.00 €  |
| 31 | Hapja e gropave te shtyllave me dim.50x50x100cm, në cdo tri metra , duke llogaritur edhe transportimin e dheut në deponi.   | cope | 1 | 60.00 €  | 60.00 €  |
| 32 | Furnizimi dhe punimi i bazamentit të shtyllave nga betoni i armuar C25, dhe me dimensione 50 x 50 x 80cm,të vendosura në distancë aksiale --300cm,ne çmim duhet te llogaritet edhe shtresa e tampont nën bazament me trashësi 1=20cm i ngjeshur nga fraksioni 0-60. Para betonimit vendoset ankeret për shtyllat kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 80mm x 80mm (me trashësi të profilit 4mm) me lartësi 600 mm te ljer me pare me dy shtresa ngjyrë antikoroitve.Detali rrethoja 1 Në çmim llogaritet edhe armature e nevojshme per themelin si ne detalin e dhene   | cope | 1 | 58.00 €  | 58.00 €  |
| 33 | Furnizimi me material si dhe punimi i rrethojës (sipas detalit të dhënë ) për fushen sportive, pozicioni përshihë këto aktivitete<br>1. Saldimi i shtyllave kryesore me ankeret e shtyllave,<br>2. Montimi i shtyllave kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 060x60mm (me trashësi të muereve të profilit 4 mm) me lartësi 4.0m.<br>3. Montimi i rrethojës prej rrejtës së çelikut Q335, pozicioni përshihë edhe kornizën për rreth saj me profile të çelikut L 40mm x 40mm me trashësi të profilit 4mm, pllakat per lidhje me shtyllat kryesore (100x200x5) mm. (brenda dy shtyllave kryesore i kemi dy rrejtja me korniz te lidhura me pllaka 100x200x5 mm si ne detali)<br>4. Punimi dhe montimi i dy dyer me dimensione (100/210) cm me profile c40x40x3 te plotësuar me rrejt Q335 si në rrethojë, per komplet fushën, ( ne pozicion parashihet brava me çelës ,bagllamët, profili për mbështetje te derës dhe elementet tjera te nevojshme për funksionalizim). Në çmim duhet llogaritur prenja, pasftrimi, saldimi , ngjyrosja , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorooues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detalit dhe nen mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës. Detali rrethoja 1<br>Llogaritja për m² të rrethojës | m²   | 1 | 85.00 €  | 85.00 €  |

|  |          |                 |                 |
|--|----------|-----------------|-----------------|
| <p>Furnizimi me material si dhe punimi i rrethojës (sipas detajit të dhënë ) për lushen sportive, pozicioni përfshinë këto aktivtete</p> <p>shytlave,</p> <p>1. Saldimi i shytlave kryesore me ankeretë e 2. Montimi i shytlave kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 80x80mm (me trashësi të mureve të profilit 4 mm) me lartësi 4.5m. 3. Montimi i rrethojës prej rrethës së çelikut Q335, pozicioni përfshinë edhe kornizën për rreth saj me profile të çelikut L 50mm x 50mm me trashësi të profilit 4mm, pllakat për lidhje me shyllat kryesore (100x200x5) mm. (brenda dy shytlave kryesore i kemi dy rrethja me kornizë të lidhura me pllaka 100x200x5 mm si ne detal)</p> <p>4. Punimi dhe montimi i dy dyer me dimensione (100x210) cm me profile 40x40x3 të plotësuar me rreth Q335 si në rrethojë, për komplet fushën, ( në pozicion parashihet brava me qelës , bagllamët, profili për mbështetje të derës dhe elementet tjera të nevojshme për funksionalizim). Në çmim duhet llogaritur prerja, pastrimi, saldimi , ngjyrosja , fillimisht me ngjyrë minium -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detajit dhe nën mbikëqyrjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës. Detajit rrethojës 1</p> <p>Llogaritja për m<sup>2</sup> të rrethojës</p>   | <p>1</p> | <p>95.00 €</p>  | <p>95.00 €</p>  |
| <p>Furnizimi me material, sanimi si dhe ngjyrosja e rrethojës ekzistuese.</p> <p>Pozicioni përfshinë këto aktivtete:</p> <p>Largimi i pjesëve të dëmtuara, montimi i pjesës së re, zallimi i rrethojës ekzistuese, saldimi i pjesëve të dëmtuara, i pjesës së re në pjesën ekzistuese, ngjyrosja me ngjyrë antikorodim dhe ngjyrosja me dy ngjyra për metale me njëanës -ngjyrë sipas menaxherit të projektit. Dy shtresat duhet të kenë ngjyrë të ndryshme në mënyrë që të mbulohen elementet komplet me dy ngjyra</p> <p>Llogaritja për m<sup>2</sup> të rrethojës</p>   | <p>1</p> | <p>25.00 €</p>  | <p>25.00 €</p>  |
| <p>Furnizimi me material si dhe punimi i derës rrëshqitëse, prej profileve metalike, me gjerësi 5500mm dhe lartësi 2000mm.</p> <p>1. Hapja e gropave për themelet e shytlave me dimensione 400mm x 400mm x 900mm 2 copë.</p> <p>2. Montimi i ankerave për shyllat kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 80mm x 80mm (me trashësi të profilit 4mm) me lartësi 600 mm.</p> <p>3. Shtuesja e një shtrese prej zhavorit 0-60 me trashësi 200mm</p> <p>4. Betonimi i themelit të veçuar me dimensione 400mm x 400mm x 700mm</p> <p>5. Montimi i shytlave kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 60mmx60mm (me trashësi të mureve të profilit 3mm) me lartësi 2000mm.</p> <p>6. Montimi i derës prej rrethës së çelikut Q335, pozicioni përfshinë edhe kornizën për rreth saj me profile të çelikut L 50mm x 50mm me trashësi të profilit 4mm.</p> <p>7. Punimi i bazamentit (traut) prej betoni me dimensione 250mmx250mm dhe gjatësi 11000mm, i armuar me armaturë gjatësore Ø12 (4 copë ) dhe stafa Ø8/20cm</p> <p>8. Montimi i profilit metalik, L 50mm x 50mm me trashësi të profilit 4mm, për lëvizjen e derës rrëshqitëse</p> <p>9. Montimi i rrotave (2 copë) për lëvizjen e derës në drejtim horizontal. Pozicioni përfshinë edhe ngjyrosjen e derës fillimisht me ngjyrë minium (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyore (dy shtresa)</p> <p>Llogaritja për m<sup>2</sup> të rrethojës</p> | <p>1</p> | <p>900.00 €</p> | <p>900.00 €</p> |

|    |   |          |   |          |          |
|----|---|----------|---|----------|----------|
| 37 | <p>Furnizimi me material si dhe punimi i derës , prej profiëve metalike, me gjeresi 1200mm dhe lartësi 2100mm.</p> <p>1. Hapja e gropave për themelet e shtyllave me dimensione 400mm x 400mm x 900mm 2 copë.</p> <p>2. Montimi i ankerave për shtyllat kryesore prej profiëve të çelikut me dimensione 80mm x 80mm (me trashësi të profilit 4mm) me lartësi 600 mm. 3. Shtuëja e një shtrese prej zhavorit 0.60 me trashësi 200mm</p> <p>4. Betonimi i themelit të veçuar me dimensione 400mm x 400mm x 700mm</p> <p>5. Montimi i shtyllave kryesore prej profiëve të çelikut me dimensione 60mmx60mm (me trashësi të mureve të profilit 3mm) me lartësi 2000mm.</p> <p>6. Montimi i derës prej rrejtës së çelikut Q335, pozicioni përftshinë edhe kornizen për rreth saj me profile të çelikut L 50mm x 50mm me trashësi të profilit 4mm.</p> <p>përftshinë edhe ngjyrosjen e dorës fillimisht me ngjyrë minium (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa)</p> <p>Logaritja për m<sup>2</sup> të rrethojës</p> | 550.00 € | 1 | 550.00 € | 550.00 € |
| 38 | <p>Eskavimi dhe doponimi, prapaktimi, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës humusore d=30cm. Pozicioni përftshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponi në përputhje me normatvat ndërtimore</p>   | 50.00 €  | 1 | 50.00 €  | 50.00 €  |
| 39 | <p>Furnizimi, transporti dhe montimi i shtresës sipas dimensioneve minimale:</p> <p>Dimensionet gjenerale Ø: 500 mm H: 820 mm V: 70 L</p> <p>Pjesa nga betoni Ø: 500 mm H: 790 mm Ø: 60 mm</p> <p>Kapaku metalik: Ø: 500 mm H: 225 mm Ø: 3 mm</p> <p>Pjesa e mbrendshme e ndarë në tri pjesë V:22 L Ø: 1 mm -elektroegalvizuar . Pjesa e mbrendshme për cigare në një pjesë V:0,4 L Ø: 1 mm.</p> <p>Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose granit (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar.Përzjerja e poltit zgjidhet nga organi mbikqyrës( e bardhë, kaft, hiri, e zezë eij).Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2).</p> <p>Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004)</p> <p>Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019.</p> <p>Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021.</p>  | 950.00 € | 1 | 950.00 € | 950.00 € |
| 40 | <p>Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.</p>  | 10.00 €  | 1 | 10.00 €  | 10.00 €  |
| 41 | <p>Planifikimi dhe kompaktimi i sipërfaqeve të eskaviara, para hüdhes se materialit mbushes.</p> <p>Gërmimi i dheut për punimin dhe zgjerimin e niveleve tokësore të shkallëve në të dy anët,niveleve të rampave dhe të gjitha sipërfaqeve tjera që kanë nevojë për zgjerim dhe nivelim.Llogaria e gërmimit me m<sup>3</sup> të gërmuar.Në llogaria të përfshihet edhe transporti i dheut të gërmuar në deponin e caktuar nga organet komunale.</p>   | 21.00 €  | 1 | 21.00 €  | 21.00 €  |
| 42 | <p>Punimi i mbushjes së sipërfaqeve për realizimin dhe zgjerimin e niveleve të gjelbrimit si në pjerrtësi ashtu edhe në sipërfaqet e rrafshëta, me sasi nga gërmimi ( me dheun cilësor) dhe me huazim. Në llogari të hyjnë edhe ngjeshja e terrenit në trashësi sipas gjendjes në teren.</p>  | 35.00 €  | 1 | 35.00 €  | 35.00 €  |
| 43 | <p>Gërmimi, shpërndarja dhe trashësi i sipërfaqeve të pjerrta të dheut mes kaskadave, në formë sipas projektit. Në llogari të hyjnë edhe mbjellja e barit gjelbrues.</p>  | 15.00 €  | 1 | 15.00 €  | 15.00 €  |
| 44 | <p>Punimi i mbushjes së sipërfaqeve për realizim të mbushjes dhe krijimit të pjerrtësisë jashtë murit rrethues nga rampat,në drejtim të parkut që të krijohet një skenar dekorues dhe shkurtim të lartësisë së murit dukës, me sasi nga gërmimi ( me dheun cilësor )dhe me huazim. Në llogari të hyjnë edhe ngjeshja e terrenit në trashësi sipas gjendjes në teren.</p>  | 15.00 €  | 1 | 15.00 €  | 15.00 €  |
| 45 | <p>Sjellja, shpërndarja, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës humusore d=30cm (mbushje humusi)..</p>   | 22.00 €  | 1 | 22.00 €  | 22.00 €  |
| 46 | <p>Furnizimi me zhavor nga gurthyesi 060mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimi 40Mpa,t=25 cm</p>  | 28.00 €  | 1 | 28.00 €  | 28.00 €  |

|    |   |                |   |          |          |
|----|---|----------------|---|----------|----------|
| 47 | Furnizimi me zhavor nga gurtlyesinga gurtlyesi 032mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktuesimi 40Mpa, t=10cm   | m <sup>2</sup> | 1 | 30.00 €  | 30.00 €  |
| 48 | Furnizimi me zhavor nga gurtlyesi d=0.2mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktuesimi..  | m <sup>2</sup> | 1 | 35.00 €  | 35.00 €  |
| 49 | Furnizimi dhe punimi i shtratis të kubëzave me zhavor të imët 0-4 mm me trashësi prej min 5 cm. Në llogari të futes furnizimi shtrija dhe ngjeshja e nevojshme ku duhet. Llogaritur për m <sup>2</sup> të punuar.   | m <sup>2</sup> | 1 | 35.00 €  | 35.00 €  |
| 50 | Punimet e kallupimit, furnizimi dhe sjellja e betonit C 25/30, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e coklace dhe mureve mbrojtëse si dhe shkallve të fushave.   | m <sup>3</sup> | 1 | 180.00 € | 180.00 € |
| 51 | Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses nga metali-sipas dimensioneve minimale:<br>Dimensionet L: 191 cm B: 61cm H: 80 mm Peshat: 42 kg<br>Këmbët nga metali 2 copë çeliku S 235 JR EN 10025, e mbuluar me primer hibrid ester-epoksid (ISO14001:2015)<br>poliester i ngurtë elektrostatik pihur (ISO14001:2015). Dërrasi 7 copë dru i butë brendi i certifikuar nga FSC shtresat e sipërme të pigmentuara me ujë (Impregnator dhe lak) (ISO 9001). Llogot 2 copë ø33mm me mbishkrim Hynessa në fron apo iloto, çelik inox AISI 304. Sipas standardeve EN 581-1:2017, EN 581-3:2017. Ngjyra zgjidhet nga organi mbikqyrës. Dhe të gjitha materialet shtesë me bulona me përfordim në tokë. | copë           | 1 | 780.00 € | 780.00 € |
| 52 | Prejra dhe largimi i pemëve të vjetra neper dhe meth terreneve sportive si dhe krasija e tyre .Largimi dhe transporti i mbeturinave të pemëve deri ne deponi te qytetit.  | cope           | 1 | 35.00 €  | 35.00 €  |
| 53 | Furnizimi dhe montimi i kanaleve gjatsore nga beton armeja me dimensione 200*200 mm si dhe vendosja e profileve metalike L 40*40 mm te ankeruara ne beton per vendosjen e rjetave te zingjtuara.  | m'             | 1 | 180.00 € | 180.00 € |
| 54 | Furnizimi dhe montimi i pusetave te kanaleve atmosferike me konus si dhe gypat ø 800 mm sipas nevojës si dhe vendosja e kapakul nga qiza per ngarkesa 40 ton.   | cope           | 1 | 120.00 € | 120.00 € |
